

Emër Mbiemër	<b>XHEVAHIR SPAHIU</b>
Datëlindje	<b>1 mars 1945</b>
Vendlindje	<b>Malind, Skrapar</b>
Viti i zgjedhjes	<b>2008</b>
Seksioni	<b>Shkencat shoqërore dhe albanologjike</b>
Gjuhët	<b>Frëngjisht, italisht, rusisht.</b>

---



#### **Kontakt:**

Adresa: Tiranë, Rr. "Qemal Stafa" Pall.217/1, Ap.5

Telefon: 0422 56075, cel. 069 26 14 538

Email: [xhevahir.spahiu@akad.gov.al](mailto:xhevahir.spahiu@akad.gov.al)

Faqe zyrtare: [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

#### **CV e shkurtër**

Poet, publicist, përkthyes, akademik. Kreu studimet e larta në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në UT (1967). Ka punuar gazetar në "Zërin e popullit" (1968–1977), redaktor në revistën "Nëntori" (1978–1986), mësues (1986–1989), libretist në *Teatrin e Operës dhe Baletit* (1989–1993), sekretar i përgjithshëm i *Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë* (1993–1998) dhe kryetar i saj (1998–2001). U afirmua si poet në fund të viteve '60 me zërin e tij të spikatur poetik. Vargu i lirë e konciz, ritmi dinamik i ligjëritimit dhe mendimi përgjithësues i shprehjes metaforike, janë tiparet dalluese të krijimtarisë poetike të Xhevahir Spahiut. Poezitë e tij me frymë qytetare e polemiste, të prira nga lirizmi, meditimi psikologjik e sentenca poetike, shpesh përjetohen si dialogë me historinë dhe aktualitetin e botës shqiptare. Ka botuar librat "Vdekje perëndive" (1977), "Zgjimi i thellësive" (1979), "Nesër jam aty" (1987), "Kohë e krisur" (1991), "Ferrparajsa" (1994), "Pezull" (1996), "Rreziku" (2001) etj., si edhe përmbledhjen me poezi të zgjedhura "Udha" (I, II, 2005). Ka fituar disa çmime kombëtare. Poezi e libra të tij janë përkthyer në disa gjuhë. Mban Urdhrin "Mjeshtër i Madh".

#### **Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)**

*Libra me poezi:*

"Mëngjes sirenash", 1970;

"Vdekje perëndive", 1977;

"Zgjimi i thellësive", 1979;

"Agime shqiptare", 1981;

"Nesër jam aty", 1987;

"Heshtje s'ka", 1989;

“Kohë e krisur”, 1991;  
“Ferrparasja”, 1994;  
“Pezull”, 1996;  
“Rreziku”, 2001.

- Përmbledhja e zgjedhur në kolonën “Poezia Shqipe”, botuar më 1990.
- Përmbledhja e zgjedhur “Udha” I,II, botuar në vitin 2005.
- Në Kosovë kanë dalë tri përmbledhje të zgjedhura poetike:  
    “Epikë” (bashkautor), 1978;  
    “Vdekje perëndive”, 1981;  
    “Tek rrënja e fjalëve”, 1988.
- Përmbledhje me poezi “Vetëtimë”, 2013

*Libra me poezi për fëmijë:*

“Ti qytet i dashur”, 1973;  
“Zambakët e Mamicës”, 1981;  
“Ekрани i kaltër”, 1982;  
“Kitaristët e vegjël”, 1983;  
“Kryeartëzat”, 1987;  
“Dielli i lodrave”, 1990;  
“Zogj të kaltër”, (përmbledhje e zgjedhur, 1999).  
Ribotim i librit me poezi për fëmijë “Zogj të kaltër”, 2010.

*Përmbledhje me eseistike dhe reportazhe letrare:*

“Dyer dhe zemra të hapura”, 1978;  
“Bashkëkohësit”, 1980;  
“Plaku i këngës”, monografi (bashkautor), 2002.

*Libra me përkthime nga poezia botërore:*

“Zemra pa mure”, 1992;  
“Këtej nuk kalon askush”, 1997;  
“Përtej meje”, 1999;  
“Zotit”, 2004.

*Në gjini të tjera letrare-artistike:*

- Autor i shumë teksteve poetike të këngëve të muzikës së lehtë.
- Autor i disa skenarëve të filmave dokumentarë artistikë.
- Poezia e tij është përfaqësuar gjerësisht në të gjitha antologjitë e poezisë shqipe të botuara gjatë 20 viteve të fundit në Shqipëri dhe në gjuhë të huaja.
- Veprat e tij analizohen në tekste të letërsisë dhe të gjuhës shqipe, ku janë botuar dhe pjesë, në të gjitha kategoritë e shkollave, që nga cikli i ulët e deri në shkollat e larta. Kritika ka thënë fjalën e saj vlerësuese në dhjetëra recensione dhe artikuj studimorë.

### **Botime në gjuhë të huaj:**

- Libra dhe pjesë të zgjedhura të krijimtarisë poetike janë botuar në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, holandisht, maqedonisht, turqisht, rusisht, greqisht, rumanisht, arabisht, japonisht, kineze, kroatisht, hebraisht etj.
- Eseja “Nderim Perliçevit”, botuar në maqedonisht, 2007.
- Botim i vëllimit me poezi, në gjuhën frënge, prezantuar në Francë 2011.

### **Çmime letrare:**

- Çmimi II në Konkursin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut për reportazhin letrar “Labëri, Labëri”, 1969.
- Çmimi I “Reportazhe të vogla të kohës së madhe” në Konkursin Kombëtar letraro-artistik “30-vjetori i Çlirimit të Atdheut”, 1974.
- Çmimi i LSHA për “Kitaristët e vegjël”, si libri më i mirë për fëmijë i vitit 1983.
- Çmime letrare kombëtare nga revistat “Nëntori”, “Hosteni”, gazetat “Drita”, “Pionieri”, etj.
- Fitues i filmit dokumentar, 1984.
- Fitues i filmit dokumentar, 1986.
- Çmimi Letrar Kombëtar “Migjeni” për librin më të mirë të vitit 1987 “Nesër jam aty”.
- Çmimi I në Konkursin Letrar Kombëtar për librin “Heshtje s’ka”, 1989.
- Çmimi Letrar Kombëtar “Migjeni” për librin më të mirë të vitit 1991 “Kohë e krisur”.
- Çmimi Special në Konkursin Ndërkombëtar “Les muses d’Or”, Paris 1993.
- Çmimi Letrar Kombëtar për librin më të mirë të vitit 1994 “Ferrparajsa”, (dhënë nga Ministria e Kulturës).
- Çmimi Letrar Kombëtar “Velija” për librin më të mirë të vitit 1996 “Pezull”.
- Çmimi I për tekstet poetike në Festivalet Kombëtare të Muzikës së Lehtë si dhe disa çmime të dyta, në vitet 1976, 1979, 1989, 1995.
- Çmimi Letrar i Karrierës: “Një jetë poetike”, 2001 (nga LSHA).
- Çmimi “Mësonjëtorja e parë” për librin “Rreziku”, 2001.
- “Diploma de Excelenta” akorduar nga Ministria e Kulturës e Rumanisë në Festivalin Ndërkombëtar “Netët e Poezisë të Curtea de Arges”, 2003.
- Çmimi “Nositi” nga Festivali Ndërkombëtar “Poeteka”, Durrës, 2006.
- Fitues i çmimit “Poezia, art i fjalës”, dhënë nga Shoqata e artistëve “Pushkin”, Tetovë, 20007.
- Fitues i çmimit “Penda e Artë”, dhënë nga Bashkia Berat, 2010.

### **Tituj:**

- Titulli “Qytetar Nderi”, dhënë nga Këshilli Bashkiak, Skrapar 2005.
- Titulli “Nderi i Frashërit”, dhënë nga Këshilli i Komunës së Frashërit, 2005.
- Titulli “Nderi i Martaneshit”, dhënë nga Komuna e Martaneshit, 2006.

### **Urdhra dhe medalje:**

Medalja “Naim Frashëri”, 1972.

Medalja e Punës, 1974.

Urdhri “Naim Frashëri”, kl.II, 1982.

Urdhri “Mjeshtër i Madh” dhënë nga Presidenti i Republikës, Tiranë 2005.